



Reagimi i diasporës shqiptare në Austri

Diaspora Shqiptare në Austri, në lidhje me ngjarjet e fundit në Maqedoni dhe Luginën e Preshevës, shpreh reagimin dhe indinjtatën e sajë ndaj klimës së paragjykitimit kolektiv dhe terrorit që ushtron sistematikisht, Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë në krye me Ministren Jankulovska, si dhe ajo e Serbisë në krye me Ministrin Daçiç, ndaj qytetarëve të pafajshëm shqiptarë, ku në kontinuitet po shkelet shteti i së drejtës nga organet shtetërore maqedonase dhe ato serbe, kur janë në pyetje akuzat ndaj shqiptarëve.

Në IRJM, Ministria e Punëve të Brendshme në kontinuitet po përdor forcën e sajë kundër qytetarëve të sajë shqiptarë, dhe dëshmon se vepron kundër principeve për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Krimi është krim në çdo gjuhë, në çdo etni dhe në çdo shoqëri. Ndaj, nuk ka krim kolektiv dhe nuk ka ndëshkim kolektiv.

Institucionalizimi i krimit kolektiv, vë në rezik, jo fatin e shqiptarëve por përkundrazi të ardhmen e vetë Maqedonisë. Skenat e arrestimit të motrave dhe vëllezërve tanë, ku më shumë se gjysma e të arrestuarve dalin të pa fajshëm nga gjykatat e politizuara maqedonase, janë për ne të papranueshme.

Shqiptarët gjatë gjithë historisë së tyre, nuk kanë treguar nacionalizëm agresiv bazuar mbi etninë dhe fenë e maqedonasëve. Ne si Shqiptarë kemi dëshmuar tolerancë dhe e kemi pranuar bashkjetesën me bashkëqytetarët tanë sllavomaqedonë, mirëpo ngjarjet që ju paraprinë ky koalicion qeveritar në IRJM po tregojnë sa e brishtë është situata në Maqedoni.

Refuzimi për të dëgjuar dhe komunikuar me shqiptarët dhe me përpjekjet e tyre për të dëmtuar imazhin tonë janë të kota.

Shqiptarët kudo në rajon e kanë dëshmuar veten e tyre se janë tolerant dhe me aspiratë perëndimore. Palën maqedonase nuk duhet ta gënjejë mendja se vëndi mundet të ecë përpara në kurriz të shqiptarëve, apo edhe më keq duke nëpërkëmbur të drejtat e tyre legjitime. Ky mentalitet antishqiptar me të cilin kërkon të qëndrojë në pushtet qeveria e gruevskit në Shkup, tregon se kriza politike dhe ekonomike po thellohet për çdo ditë e më shumë në kurriz të shqiptarëve.

Me këte rast diaspora shqiptare në Austri kërkon nga partia politike shqiptare që participon në qeverinë aktuale të Maqedonisë të jetë në vigjile të ngjarjeve dhe të distancohet nga politika sunduese e Gruevskit, ndërsa nga faktori ndërkombëtar të reagojë ndaj dhunës, dhe mënyrës së arestimeve të bazuara në bazë selektive të cilat ushtrohen ndaj shqiptarëve të pafajshëm, të cilat janë të orkestruara mes Shkupit dhe Beogradit.



Shoqatat të cilat e përkrahin këtë reagim janë:

1. Unioni i shqiptarëve musliman në Austri, Gutenbergstr. 5, 4600 Wels
2. Shoqata kulturore Islame, Bayerhamerstr. 21, 5020 Salzburg
3. Bashkësia kulturore shqiptare "Ikre", Bahnhofstr. 13, 4800 Attnang-Puchheim
4. Bashësia shqiptare muslimane në Wels, Gutenbergstr. 15, 4600 Wels
5. Shoqata e grave shqiptare "Ardhmëria", Waldegstr. 59, 4020 Linz
6. Shoqata shqiptare "Bashkimi", Waldegstr. 59, 4020 Linz
7. Shoqata kulturore sportive "Kosova", Krempplstr. 3, 4020 Linz
8. Shoqata kulturore sportive "Dardania", Friedhofstr. 6, 4020 Linz
9. Shoqata shqiptare "Bujaria", Göthestr. 32, 4020 Linz
10. Radio Pendimi, Göthestr. 32, 4020 Linz
11. Shoqata shqiptare në Wien, Menzlgasse 15/1-4, 1160 Wien
12. Shoqata shqiptare "Abdyl Frashëri", Wilhelmsburgerstrasse 11, 3151 St. Pölten
13. Bashkësia muslimane e shqiptarëve në Hollabrunn, Wienastr. 57, 2020 Hollabrunn
14. Bashkësia muslimane e shqiptarëve "Nur", Gfiderstr. 7, 2630 Ternitz
15. Bashkësia shqiptare "Shar", 8020 Graz
16. Shoqata Kulturore shqiptare "Vëllazëria", Wienerstrasse 20, 3493 Hadersdorf am Kamp
17. Liga shqiptare e futbollit në Austri
18. Forumi i të rinjve musliman, Menzlgasse 15, 1160 Wien
19. Shoqata kulturore sportive "Iliria", Burgergasse 13, 1100 Wien



VKS-SHKS ILIRIA
1100 Wien, Bürgerg. 13

VEREIN ALBANISCHER MUSLIME IN WIEN
BASHKËSIA ISLAME SHQIPTARE NË VIENË

1160 Wien, Menzlgasse 15/1-4
Tel.: 01/957 80 24, Mobil: 0650/925 77 98
Fax: 01/957 80 24



Halisei

Islamische Kulturverein
AL-IHLAS

Shoqata Kulturore Islame
Bayerhamerstr. 21, 5020 Salzburg

M. Veli

Ardhmeria
Albanischer Kulturverein | Waldegstr. 59 | 4020 Linz



LIGA SHQIPTARE E FUTBOLLIT NË AUSTRI

